



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution**

Në bazë të Nenit 3 pika 7 dhe të Nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (LSHCRK), përkatësisht të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Institucioni i Avokatit të Popullit rishpall:

## **K O N K U R S**

Titulli i vendit të punës: **Përkthyes serbisht - shqip - serbisht** (Një pozitë)

Referenca: IAPK – 2/2014

Paga-koeficienti: 11,30

Mbikqyrësi: Drejtori i Administratës

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar, periudha provuese 12 muaj.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Të përkthejë në mënyrë profesionale materialet dhe dokumentet e ndryshme,
- Të përkthejë në mënyrë gojore gjatë intervistave, takimeve, konferencave, seminareve dhe trajnimeve, brenda dhe jashtë hapësirave të IAP,
- Të sigurojë përdorimin e terminologjisë ligjore që përdoret në njësinë e përkthimit,
- Të mbajë, rregullojë dhe mbikëqyrë shënimet në lidhje me shërbimet e ofruara nga ana e njësisë së përkthimit dhe të mbajë statistikën e dokumenteve të përkthyer,
- Të kryejë detyra tjera të cilat mund t'i caktohen nga eprori i tij/saj.

### **Përgatitja profesionale, kualifikimi, aftësitë dhe karakteristikat tjera:**

- Diplomë universitare - e obligueshme, kurse përparësi do të ketë kandidati - individi me diplomë universitare në lëmin e gjuhësisë,
- Njohja e gjuhës serbe dhe shqipe me shkrim dhe në të folur, e obligueshme,
- Dy (2) vite përvojë pune në administratë apo në arsim, e obligueshme,
- Njohje e programeve kompjuterike të Microsoft Office dhe të internetit, e obligueshme,
- Inkurajohen kandidatët - individët me gjuhë amtare serbe.
- Gatishmëri e lartë për të punuar në ambiente multikulturore dhe multigjuhësore,
- Gatishmëri për të punuar nën presion kohor, në rrethana të jashtëzakonshme dhe jashtë orarit të punës.
- Vërtetimin nga gjykata se nuk është nën hetime apo i dënuar për veprë penale (jo më i vjetër se 6 muaj) – i obligueshëm.

### **Procedura e konkurimit**

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit.

[Formularët për punësim](#) mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen e internetit: [www.ombudspersonkosovo.org](http://www.ombudspersonkosovo.org).

Formularët për punësim mund të dorëzohen personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Enver Maloku“, nr. 28, Bregu i diellit, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për veprë penale.

### **Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët**

Institucioni i Avokatit të Popullit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës pa asnjë dallim.

Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në rast të numrit të madh të aplikacioneve, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

**Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 11 prill 2014.**

Kërkesat e dërguara pas kalimit të afatit për aplikim, dhe ato të pakomletuara nuk do të shqyrtohen.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në nurmin e telefonit 038 223 782 apo në email adresën [zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org](mailto:zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org)

---

*Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar por, nuk janë zgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimimit, gjegjësisht 90 ditë nga momemnti i skadimit të afatit të aplikimit. Dokumentet që nuk tërhiqen asgjësohen.*